



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 7, Datë 07.03.2014

**P Ë R**

**MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR RESORTIN TURISTIK NË  
FSHATIN GJILEKË, DHËRMI, BASHKIA HIMARË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 "Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 "Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për resortin turistik në fshatin Gjilekë, Dhërmi, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, me subjekt zhvillues "EUROCOL" Sh.p.k.
2. Të Bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi:
  - a. Dokumenti i rregullores së lejes zhvillimore komplekse;
  - b. Harta e planvendosjes së strukturave, shoqëruar me parametrat e plotë të zhvillimit.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet zhvilluesit vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**Znj. EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**



**SEKRETARE E KKT**

**Znj. ADELINA GRECA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

